



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 589/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohen programet e studimit i BPrAL Kolegji “Universum”:

- Shkenca Kompjuterike, MSc. 120 ECTS;
- Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS;
- Infermieri - Mami (Ferizaj), BA, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji “Universum” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programit të studimit: Shkenca Kompjuterike, MSc. 120 ECTS, Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS, dhe Infermieri - Mami (Ferizaj), BA, 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Shkenca Kompjuterike	MSc	120	Petrit Nahi, Arbana Kadriu, dhe Agon Memeti
2	Dizajn i Integruar	BA	180	Artan Xhakli, Verona Ahmeti, dhe Perparim Calaj
3	Infermieri - Mami	BA	180	Violeta Zatriqi, Skender Zatriqi, dhe Ferat Sallahu

AKA ka organizuar vizitë në Kolegji “Universum” më 22.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik, Peeter Normak dhe Alan Brickwood.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit “Universum”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për sa i përket programit të studimit Shkenca Kompjuterike, MSc, 120 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, plan programi i propozuar për Master në Shkenca Kompjuterike ka tri specializime të cilat sipas ekspertëve, rezultatet e të nxënit për të tria specializimet nuk janë specifike, dhe për shkak të formulimit të përbashkët për të gjitha specializimet, ekspertët nuk kanë mundur të parashohin nëse rezultatet e të nxënit mund të arrihen. Prandaj ekspertët kanë rekomanduar që për secilin specializim të formulohen ndarazi rezultatet e të nxënit.

Sipas ekspertëve Raporti i Vet Vlerësimit nuk përmend ndonjë koncept gjithëpërfshirës didaktik dhe se formulimi i metodave të mësim nxënies dhe mësim marrjes janë në shumicën e rasteve identike.

Për sa i përket stafit akademik, ekspertët kanë mësuar se proporcioni në mes të stafit akademik part time është relativisht i ulët. Vetëm pesë nga 21 mësimdhënësit e listuar në programin e Shkencave Kompjuterike kanë punësim të përhershëm dhe se interpretimi i termave staf i përhershëm dhe staf full time për ekspertët duket se ndryshon nga termat që përdoren normalisht. Sipas ekspertëve edhe pse kontrata rregullon normën e profesorëve në 40 orë për një javë, ngarkesa reale e stafit akademik mund të jetë ndryshe meqenëse shumica nga ta duket se kanë punësim edhe në 2 apo 3 institucione të tjera.

Ekspertët kanë mësuar se në secilën lëndë janë vendosur 2 mësimdhënës – njëri nga ta me gradën PhD dhe tjetri pa gradën PhD mirëpo vetëm njeri nga pesë profesorët e listuar si full time me PhD ka deklaruar se Kolegji Universum është punëdhënësi i tij në rrjetin profesional LinkedIn. Ngjashëm sipas ekspertëve këta persona nuk kanë deklaruar si punëdhënës Kolegjin Universum në publikimit e tyre shkencore. Sipas ekspertëve kjo tregon se ata nuk e konsiderojnë kolegjin si punëdhënësin e tyre primar. Rrjedhimisht ekspertët kanë deklaruar se disponueshmëria dhe dedikimi i stafit akademik duket se është aspekti më problematik i programit.

Një aspekt tjetër i habitshëm sipas ekspertëve ishte diskutimi i përmbajtjeve të lëndëve të ndryshme me stafin akademik. Sipas ekspertëve ata nuk kanë qenë në gjendje që të ju përgjigjen pyetjeve të thjeshta dhe direkte në lidhje me metodat mësimdhënies dhe mjeteve që ata përdorin për mësimdhënie. Dhe nga mënyra e shpjegimit të tyre, ekspertët kanë mësuar se disa nga mësimdhënësit janë vendosur si profesor në lëndë në formë arbitrare. Kjo sipas ekspertëve do të thotë se kualifikimi i stafit akademik nuk korrespondon gjithmonë me lëndët e vendosura për ta – çka është mjaft e papërshtatshme. Po ashtu ekspertët kanë deklaruar se kërkesat formale të kualifikimit nuk janë përmbushur gjithmonë.

Për sa i përket hulumtimit, ekspertët kanë gjetur pak dëshmi për ndonjë aktivitet të hulumtimit në ICT. Sipas ekspertëve shumica e hulumtimit kryhet jashtë kolegjit sepse stafi ka listuar lidhjet e tyre me institucione të tjera nëpër publikimet e tyre shkencore.

Për sa i përket programit të studimit Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve qëllimet dhe objektivat e programit ishin të detajuara, impresive dhe mjaft shumë konsistente me misionin e kolegjit. Megjithatë për ekspertët ishte e paqartë nga ana e diskutimeve me stafin akademik se si një kornizë aq e gjerë dhe ambicioze e rezultateve të të nxënies mund të arrihej nga mënyra se si programi është hartuar. Ekspertët kishin përshtypjen nga RVV se programi ishte më tepër teorik, dhe është hartuar për të pranuar një grup shumë të madh të studentëve prej 200 për një vit, të cilët vijjnë prej kualifikimeve të ndryshme paraprake, dhe të cilët do të ndjekin një program të gjerë dhe teorik me shumë pak mundësi për përvojë praktike.

Sipas ekspertëve edhe nëse programi i hartuar në këtë mënyrë të gjerë do të ishte i përshtatshëm ka qenë vështirë të kuptohet nga ekspertët për shkak të dokumentacionit shumë jo konsistent. Ekspertët janë hutuar se pse disa lëndë janë përfshirë dhe disa të tjera nuk janë përfshirë. Ngjashëm lëndët sipas ekspertëve kishin tituj të ndryshëm dhe nuk ishte krejtësisht e qartë se cilat lëndë i ligjërohen cilëve studentë, për shkak të informatave jo konsistente që ishin prezantuar në dokumentacion.

Ekspertët kanë deklaruar se forma, përmbajtja dhe balanci i programit ashtu siç është përcaktuar në dokumentacion është jo konsistent, konfuz, në disa raste i papërshtatshëm dhe rrjedhimisht jo i përshtatshëm për të dhënë një titull akademik. Sipas ekspertëve programi nuk është kuptuar saktë nga stafi akademik dhe nuk është i standardit ndërkombëtarë.

Për sa i përket stafit akademik ekspertët kishin vështirësi për tu angazhuar me stafin akademik, përgjegjës për program. Dy nga tre anëtarët e stafit akademik nuk ishin në gjendje që të komunikojnë në mënyrë të efektshme në gjuhën angleze. Anëtari kryesor për Dizajn Enterieri nuk ishte në listën e aprovuar të AKA-së dhe prandaj nuk ishte prezent. Kjo ka bërë që Dizajnimi i Produkteve dhe shumica e inputit për stafin akademik të jetë për bartësin e programit i cili nuk është i kualifikuar apo më përvojës në Dizajn dhe as në mësimdhënie në arsim të lartë.

Për sa i përket programit të studimit Infermieri – Mami, BA, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve deklarata e vizionit dhe misionit e programit nuk reflekton filozofinë e infermierisë. Programi është i orientuar në mjekësi dhe duhet të rishikohet për të përfshirë filozofinë e gjitha fushave që ligjërohen. Sipas ekspertëve standardet akademike janë të larta mirëpo nuk reflektojnë direktivën e BE-së dhe standardet për infermierë sepse në këtë kohë vetëm programi i infermierisë është prezantuar.

Sipas ekspertëve, gjithë personat përgjegjës për implementimin e programit janë specialist/ doktor të mjekësisë me kompetencë dhe kualifikime të larta akademike. Megjithatë Direktiva e BE-së është e qartë për faktin se ofruesit e lëndëve për infermieri si dhe menaxheri i programit mund të jetë vetëm infermier i kualifikuar në nivelin akademik, dhe për momentin ky nuk është rasti në Kolegjin Universum. Sipas ekspertëve, Infermiera është profesion autonom dhe i pavarur me fushat dhe kompetencat e veta, konsistent me direktivën e BE-së.

Për sa i përket përmbajtjes së programit ekspertët kanë deklaruar se kurrikula përmban gjitha elementet që duhet të përfshihen në strukturën e kurrikulës megjithatë shpërndarja e orëve në disa lëndë është jo logjike. Klinika praktike nënkupton kontakt direkt me pacientët në një ambient klinik. Për më tepër orët laboratorike janë të shumta dhe se janë përfshirë në disa lëndë të cilat nuk janë krejtësisht të përshtatshme për tu shpenzuar në një laborator. Sipas ekspertëve, bartësit e programit të cilët kanë tituj të lartë akademik në fushën e mjekësisë, nuk kanë qenë në gjende që të shpjegojnë se pse kurrikula është strukturuar në atë mënyrë.

Për sa i përket pajisjeve ekspertët kanë deklaruar se institucioni është pajisur me shtretër dhe manekin dhe disa modele për të mësuar anatominë, psikologjinë dhe gjinekologjinë. Megjithatë sipas ekspertëve pajisjet janë të vjetra dhe se nuk janë të papërshtatshme për qëllimet arsimore. Po ashtu ekspertët kanë deklaruar se qëllimi i menaxhmentit për të regjistruar 200 studentë për këtë program është plotësisht i papranueshëm.

Përfundimisht ekspertët kanë deklaruar se Kolegji Universum nuk ka staf akademik të mjaftueshëm dhe kompetent për të ofruar programin e studimit në Infermieri. Edhe pse institucioni ka angazhuar 4 PhD ata janë të kualifikuar në mjekësi dhe jo infermieri.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet në Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Kjo këshill juridike jepet duke u bazuar në nenin 157 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr.05/L-031, datë 25 maj 2016) i cili ka hyrë në fuqi me 21 qershor 2017. Sipas këtij neni Procedurat administrative të filluara dhe të pa përfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar procedurën administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Universum";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë